

Koment

Mbi ndryshimet ne ligjin “Per Tatimin mbi te Ardhurat” ne kushtet e Covid-19

Në ligjin 8438 dt. 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, të ndryshuar keni:

Neni 29

Deklarimi tatimor dhe llogaritja perfundimtare e detyrimit

1. Çdo tatimpagues pergatit deklaraten vjetore te te ardhurave te tatueshme ne formen e percaktuar ne udhezimin e Ministrit te Financave ne zbatim te ketij ligji. **Tatimpaguesit paraqesin deklaraten vjetore ne organet tatimore brenda dates 31 mars te vitit pasardhes, duke paraqitur ne te njejten kohe bilancin kontabel,** se bashku me anekset e tij, si dhe çdo te dhene tjeter te percaktuar ne udhezimin e Ministrit te Financave ne zbatim te ketij ligji. Per efekte fiskale, te dhenat e dokumenteve te mesiperme quhen te pranuar, kur miratohen nga administrata tatimore ose kur kalojne dy muaj pas dorezimit te tyre zyrtar dhe administrata tatimore nuk pergjigjet zyrtarisht.

2. **Tatimi i llogaritur në bazë të deklaratës vjetore** të të ardhurave të tatueshme, **pakësuar** me shumat e përcaktuara sipas nenit 37 te ketij ligji dhe **me parapagimet** e bëra gjatë periudhës tatimore, paguhet nga tatimpaguesi në llogarinë e organeve tatimore, ne çastin e paraqitjes së deklaratës vjetore të të ardhurave të tatueshme.

3. Shfuqizohet

Ne baze te kesaj dispozite per deklarimin tatimor dhe llogaritjen perfundimtare e detyrimit veçohen dy momente:

a) **brenda dates 31 mars** te vitit pasardhes Tatimpaguesit **paraqesin deklaraten vjetore** ne organet tatimore

b) **brenda dates 31 mars** te vitit pasardhes Tatimpaguesit **paraqesin bilancin kontabel** ne organet tatimore (se bashku me anekset e tij, si dhe çdo te dhene tjetër te percaktuar ne udhezimin e Ministrit te Financave ne zbatim te ketij ligji).

Ti analizojme me radhe keto dy momente :

I. Per deklaraten e Tatimit mbi Fitimin te bilancit 2019

Ne ligjn 31/2020 dt. 16.04.2020 për miratimin e **Aktit Normativ, me fuqinë e ligjit nr. 10, datë 26.3.2020**, të Këshillit të Ministrave, “Për një ndryshim në ligjin 8438 dt. 28.12.1998, “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, të ndryshuar” ku kemi:

Neni 1

Pas pikës 9, të nenit 38 “Dispozita kalimtare”, shtohet pika 10, me këtë përmbajtje:

“10. Përjashtimisht nga parashikimet e neneve 29 dhe 30, të këtij ligji, për deklarimin dhe pagesën e tatimit mbi fitimin, në vitin 2020, afatet e deklarimit dhe të pagesës janë, si më poshtë vijon:

a) **Bilanci kontabël**, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo e dhënë tjetër e përcaktuar në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat, në zbatim të këtij ligji, **dorëzohet brenda datës 31 korrik 2020**;

Pra sipas kesaj dispozite pesoi shtyrje dorezimi i bilancit, **por jo dorezimi i deklarates se Tatimit mbi Fitimin** dhe qe do te thote qe

- **Bilancin** mund te dorezohet brenda dates **31 Korrik 2020**
- **Deklaraten dhe pagesen** e Tatimit mbi fitimin duhet te dorezohej dhe te paguhej detyrimi i mundeshem benda dates **31 Mars 2020**

Ne paranteze, **per mos dorezimin e bilancit ne afat nuk ka asnje penalitet te drejtperdrejte**, por vetem nje penalitet (gjobe) prej 50.000 lekesh per mos dhenie informacioni ndaj DPT-se, penalitet ky indirekt **dhe i diskutueshem**, por qe perdoret nga administrata tatimore.

Mbi bazen e ketij konstatimi lindin natyreshem dy pyetje:

Se pari çfare lehtesie i krijoi biznesit shtyrja e bilancit kur nuk u shoqerua me shtyrje te pageses se tatimit mbi fitimin?

Se dyti si mund te dinte nje subjekt me daten 31 mars, se sa do ishte rezultati dhe pagesa e detyrimit tatimor me 31 Korrik?

Mbi bazen e ketyre pyetjeve konstatohen dhe dy veprime konkrete nga ana e biznesit:

Se pari ato biznese qe e konstatuan kete fakt me daten 31 Mars dorezuan nje deklarate mbi baze parashikimi dhe shpetuan nga penalitetet e mospagimit ne afat.

Se dyti ato biznese qe nuk e konstatuan kete fakt, por qe besuan te shtyrja e afatit dhe lehtesia tatimore me rastin e pandemise, e dorzuan deklaraten e tatimit mbi fitimin me 31 korrik 2020, dhe sot perballen me penalitetet per mos pagese dhe pagese te vonuar qe nga data 31 mars 2020.

Ne rast se ligjerisht kjo eshte e drejte, po moralisht?

II. Per paradhenien e Tatimit mbi Fitimin te bilancit 2020

Ligjin 8438 datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, ne nenin 29, pika 2 te sipercituar thekson:

2.Tatimi i llogaritur në bazë të deklaratës vjetore të të ardhurave të tatueshme, **pakësuar** me shumat e përcaktuara sipas nenit 37 te ketij ligji dhe **me parapagimet** e bëra gjatë periudhës tatimore, paguhet nga tatimpaguesi në llogarinë e organeve tatimore, ne çastin e paraqitjes së deklaratës vjetore të të ardhurave të tatueshme.

Pra mbi kete baze tatimi qe do rezultoje nga bilanci i vitit 2020 do te pakesohet me paradhenien qe do paguhet gjate vitit 2020 dhe diferenca (kur ka difference) paguhet brenda dates 31 Mars 2021.

Deri ketu gjithçka eshte e sakte, por le te shohim ligjn Nr. 68/2020 dt. 28.05.2020 për miratimin e **Aktit Normativ, me fuqinë e ligjit nr. 18, datë 23.4.2020**, të Këshillit të Ministrave, “për një ndryshim në ligjin 8438 dt. 28.12.1998, “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, të ndryshuar” ku kemi:

Neni 1

Në nenin 38 “Dispozita kalimtare”, të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Shkronja “c”, e pikës 10, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“ c) **Për tatimpaguesit me qarkullim deri në 14 000 000** (katërmbëdhjetë milionë) lekë, **këstet e parapagimeve** të tatim-fitimit **të vitit 2020 nuk do të paguhen.**”.

2. Pas pikës 10 shtohen pikat 11, 12 dhe 13, me këtë përmbajtje:

11. Përrjashtimisht nga parashikimet e nenit 30 "Parapagimet", të këtij ligji, për **tatimpaguesit me qarkullim mbi 14 000 000** (katërmbëdhjetë milionë) lekë, **këstet** e tatimit mbi fitimin për periudhat tatimore **të tremujorit të dytë dhe të tretë**, prill-qershor dhe korrik-shtator **2020, nuk do të parapagohen. Pagesat e këtyre kësteve shtyhen në periudhën prill-shtator 2021.** Ky përjashtim nuk zbatohet për tatimpaguesit që zhvillojnë veprimtari ekonomike në fushën e veprimtarisë bankare, të telekomunikacionit, të tregtimit të produkteve farmaceutike, të produkteve ushqimore dhe fruta-perimeve, si dhe tatimpaguesve të listuar në pikën 12, të këtij neni.

12. Përrjashtimisht nga parashikimet e nenit 30 "Parapagimet", të këtij ligji, këstet e tatimit mbi fitimin për periudhat tatimore prill-dhjetor 2020, për tatimpaguesit që zhvillojnë veprimtari ekonomike në fushën e turizmit e të përpunimit aktiv me material porositiësi dhe call center nuk do të parapagohen. Pagesat e këtyre kësteve shtyhen në periudhën prill-dhjetor 2021.

Mbi bazen e kesaj dispozite, kestet e paradhenies se dy tremujoreve per bizneset me xhiro mbi 14 milion leke, shtyhen per tu paguar ne vitin 2021.

Kjo dispozite eshte kontradiktore me ligjin baze, pasi paradhenia e vitit 2020 perfundon me 31 Dhjetor 2020 dhe diferenca per pagese nga mbyllja e bilancit te vitit 2020 paguhet me 31 Mars 2021.

Pra pas kesaj date çfare lidhje ka paradhenia e vitit 2020 qe te paguhet ne vitin 2021? Nderkohe qe shtyrja dhe automatikisht pagesa eshte ligjore dhe per mospagese ka gjobe 10%. A ka kuptim kjo gjobe?

Le ta konkretizojme me nje shembull (ne kufijte e rreales)

Nje subjekt e ka kestin e pageses se paradhenies 2.000.000 leke ne muaj per te gjithë vitin 2020, pra $12 \times 2.000.000 = 24.000.000$ leke

Rasti I Subjekti i paguan ritmikiisht paradheniet pa e shfrytezuar lehtesine e Aktit Normativ 18 si me siper dhe ne mbyllje te bilancit rezulton nje detyrim tatimor per tu paguar prej 25.000.000 leke.

Ky subjekt, ne zbatim te ligjit, me daten 31 Mars 2021 do te paguaje 1.000.000 leke (25.000.000 – 24.000.000).

Rasti II Subjekti nuk paguan paradheniet per tremujorin e dyte dhe te trete te vitit 2020 (6 muaj \times 2.000.000 leke = 12.000.000 leke) duke shfrytezuar lehtesine e Aktit Normativ 18 si me siper dhe ne mbyllje te bilancit rezulton nje detyrim tatimor per tu paguar prej 25.000.000 leke.

Ky subjekt, ne zbatim te ligjit, me daten 31 Mars 2021 do te paguaje 13.000.000 leke (25.000.000 – 12.000.000).

Por subjekti, sipas Aktit Normativ te mesiperme, kestet qe nuk paguan ne 2020 do ti paguaje ne 2021, nderkohe qe i ka mbyllur detyrimet qe me 31 Mars 2021.

Pra 2 here do ti paguaje?

Sigurisht qe Jo.

Do te paguaje gjobe per mos pagesen e paradhenies?

Varet si ta vleresoje Inspektori i DRT ku eshte tatimpaguesi, pasi kjo gjobe vendoset prej tij, dhe per rastin konkret tatimpaguesi do te paguaje gjobe 2.000.000 leke x 10% gjobe = 200.000 leke x 6 muaj = 1.200.000 leke.

A eshte e drejte kjo, ku do theksoja qe ky tatimpagues ka realisht rreth 500 te punesuar.

Çfare lehtesie ju krijua ketij tatimpaguesi?

Asgje, perkundrazi, eshte ne kushtet e penalizimit te pa drejte dhe te kundraligjeshem.

Per gjithçka parashtrova me siper, mendimin ndryshe e mirepres me rrespekt.

Vleresimi eshte i gjithsejçilit.

Luan GOSNISHTI

Auditues Ligjor

Durres 17.08.2020